



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 798 Prot.

Durrës, më 12.5.2023

VENDIM
Nr. 28, datë 12.5.2023

PËR

"MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN "PSIKO-PEDAGOGJI" NË DEPARTAMENTIN E PEDAGOGJISË, FAKULTETI I EDUKIMIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 41 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar me VKM Nr.879, datë 16.12.2019 "Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" në Udhëzimin Nr.1, datë 14.01.2020, "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", udhëzim nr.3, datë 15.02.2023 "Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike", në vendimin e Dekanatit nr.5, datë 10.05.2023 të Fakultetit të Edukimit, në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e hapjes së programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën "Psiko-Pedagogji" në Departamenti e Pedagogjisë, Fakulteti i Edukimit
2. Ky Vendim i kalon për miratim të tarifës përkatëse Bordit të Administrimit .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - ✓ Drejtuesi i Njesisë Kryesore e Fakultetit i Edukimit
 - ✓ Drejtuesi i Njesisë Bazë pranë Departamentit të Pedagogjisë
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R E T A R
Prof. Dr. *Kënan SOTIROFSKI*
DURRËS
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU"